



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi, 12.2, pika (d), lidhur me nenin 17, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", e në mbështetje të nenit 5, nënparagrafi 1.2, lidhur me nenin 11, paragrafi 1, pika 1.15 dhe neneve 16, 20 dhe 26 të Ligjit Nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 30/2013", e konform me nenin 6, paragrafi 1, pika 1.5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018, për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna dhe neneve 15, 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi I Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datë, 30.03.2022, miraton këtë:

VENDIM

Për hapjen e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit "Harta Zonale e Komunës së Suharekës 2022-2030"

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

- 1.1 MIRATOHET-** Vendimi për hapjen e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit të "Harta Zonale e Komunës së Suharekës" për periudhën 2022-2030.
- 1.2** Projekt-dokumenti nga pika 1.1 e nenit 1, e këtij vendimi, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

Neni 2

Konsultimet publike

- 2.1** Projekt-dokumenti i cekur në nenin 1 të këtij vendimi, u lihet në dispozicion për shqyrtim publik qytetarëve, agjencive, departamenteve dhe organeve të tjera për shqyrtim dhe komente, në afat prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e parë vijuese pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- 2.2** Organizimin e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit do ta bëjë Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim në Komunën e Suharekës.
- 2.3** Pas përfundimit të kohëzgjatjes së shqyrtimit publik, projekt-dokumenti së bashku me një përmbledhje të shkurtër të komenteve dhe sugjerimeve të bëra gjatë diskutimit publik dhe raportin nga shqyrtimi publik po ashtu Vendimin për pëlqim të vlerësimit strategjik mjedisor për projekt-HZK-së do t'i dorëzohen në MMPHI për pëlqim të përputhshmërisë.

Neni 3

Subjekti përgjegjës

- 3.1** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim në Komunën e Suharekës.
- 3.2** Organet tjera përkatëse kompetente do t'i kryejnë veprimet procedurale për zbatim të këtij projekt-dokumentit nga përgjegjësitë e tyre të parapara.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr- 016-19135
Më datë 30.03.2022

